

Gucati dhe Haradinaj: Përdorimi i mediave sociale si prova në gjykatat penale

1. Hyrje

Facebook, Twitter, Tiktok, Youtube, këto janë disa nga platformat e mediave sociale që ka zhvilluar epoka jonë moderne. Ndërsa zhvillimi i këtyre aplikacioneve, siç quhen në gjuhën e folur, mendohej si mjet për t'i afruar njerëzit me anë të mesazheve dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë, ato munden, dhe janë përdorur edhe si mjet për të ekspozuar krimet [ndërkombëtare].

Në vitin 2016, një emigrant irakian u dënua për krime lufte pasi një foto e tij duke mbajtur kokën e një luftëtari islamik u postua në Facebook¹, një shtetas gjerman u dënua për krime lufte dhe trajtim të rëndë përulës dhe poshtërues të ushtarëve të vdekur pasi një foto e tij duke pozuar me kokat e prera të luftëtarëve u postua në Facebook.² Ndërsa këto janë krime shumë tepër vizuale që identifikohen lehtësisht, përdorimi i mediave sociale nga autorët mund të duket i padëmshëm, por në realitet, mund të shkaktojë dëm të madh për viktimat.

Në rastin Prokurori kundër Gucati & Haradinajt në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), të pandehurit Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj zbuluan informacionin e mbrojtur të dëshmitarëve³, ata më tej bënë akuza nënçmuese dhe komente kundër dëshmitarëve. Këto vepra u transmetuan në televizion, dhe të pandehurit postuan komente në faqet e tyre përkatëse në Facebook, veprime të cilat e minojnë procedurën si dhe i vendosin dëshmitarët në pozita në të cilat ata mund të frikësohen.⁴

2. Informacioni nga burimet e hapura

Informacioni me burim të hapur është informacion i disponueshëm publikisht i cili merret përmes internetit. Informacioni me burim të hapur duhet të dallohet nga informacioni privat ose gjysmë privat, i cili, për shembull, buron nga një grup privat i Facebookut ose informacion që u dërgohet drejtpërdrejt individëve, por që nuk i vihet kurrë në dispozicion të publikut.⁵

¹Finlandë, Gjykata e Qarkut Pirkanmaa, Aktgjykimi, R 16/1304, 18 mars 2016

² Prokurori kundër Aria Ladjedvardi, Aktgjykimi, 5-3 StE 2/16 – 4 – 1/16, 12 korrik 2016

³Prokurori kundër Hysni Guçati dhe Nasim Haradinajt, KSC-BC-2020-07, aktakuzë, 4 tetor 2021, [6]

⁴ Ibid. [30]

⁵ Nikita Mehandru dhe Alexa Koenig, "Provat me burim të hapur dhe Gjykata Ndërkombëtare Kriminale" (*Harvardhrj.com*, 2022) <<https://harvardhrj.com/2019/04/open-source-evidence-and-the-international-criminal-court/>> qasur më 28 korrik 2022.

Informacioni privat dhe gjysmë privat është përdorur në lidhje me informacionin me burim të hapur në rastin e gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare.

2.1 Informacioni me burim të hapur në Dhomat e Specializuara të Kosovës

Për vlerësimin e pranueshmërinë e provave, Dhomat e Specializuara të Kosovës mbështeten në Rregulloren e Procedurës dhe Provave (RrPP) të gjykatës. Rregulli 138 i RrPP të DhSk parasheh pranueshmërinë e provave. Sipas këtij rregulli, për t'u pranuar si provë gjatë procedurës, duhet të plotësohet 'testi me tre pjesë', siç është rasti në GJNP.⁶

“Përveç rastit kur kundërshtohet ose përjashtohet proprio motu, provat e paraqitura Panelit do të pranohen nëse janë relevante, të vërteta, kanë vlerë provuese dhe vlera e tyre provuese nuk tejkalohet nga efekti i tyre paragjykes”⁷.

Testi me tre pjesë zbulon tre faktorë të rëndësishëm që duhen plotësuar në mënyrë që një gjë të pranohet si provë.

- (i) **Relevanca:** kjo nënkupton relevanca e provës në raport me rastin në fjalë. Me fjalë të tjera, ajo duhet të paraqitet me qëllim që të vërtetohet se një nga çështjet në fjalë ka pak a shumë gjasa të ketë ndodhur.
- (ii) **Vlera provuese (vërtetësia):** kjo është aftësia e saj për të arritur qëllimin që e ka për të provuar se çështja ka pak a shumë gjasa të ketë ndodhur. Në këtë aspekt, kur të vlerësoj nëse një gjë mund të pranohet në provë, gjyqtari do të shikojë besueshmërinë e saj, dhe si të tillë vërtetësinë e saj.
- (iii) **Efektet paragjykes:** kjo lidhet me faktin se gjëja e pranuar si provë nuk duhet të përmbajë ndonjë efekt paragjykes për të drejtat e të akuzuarit.

Një nga sfidat më të mëdha të informacionit me burim të hapur është aftësia për të provuar vërtetësinë e tij në mënyrë që të përdoret si provë gjatë procedurës. Për ta vërtetuar vërtetësinë e materialit me burim të hapur, ekzistojnë mënyra të ndryshme që ndryshojnë në varësi të llojit të materialit me burim të hapur. Në përgjithësi, gjykatat kanë dy mënyra për të provuar vërtetësinë e një materiali që vjen nga burime të hapura. Transkripti mund të përdoret si tregues për të provuar vërtetësinë e një videoje, e cila është provë digjitale. Gjithashtu provat digjitale si videoja mund të përdoren për të mbështetur dëshmitë verbale.⁸

Për mbështetjen⁹ e provave digjitale ekzistojnë dy lloje treguesish që mund të përdoren. Lloji i parë janë tregues të jashtëm, siç u përmend më lart, për shembull, prova ose informacione për të identifikuar burimin - kjo mund të bëhet përmes ekspertëve në fushën e burimeve të hapura, të cilët dëshmojnë për vërtetësinë e provës. Kurse treguesit e brendshëm janë vulat kohore dhe

⁶ Ibid.

⁷Dhomat e Specializuara të Kosovës, Rregullat e Procedurës dhe Provave, KSC-BD-03/Rev2/2020, 2 qershor 2020, [138]

⁸Aida Ashouri, Caleb Bowers dhe Cherrie Warden, "Pasqyrim i përdorimit të provave digjitale në Gjykatat Penale Ndërkombëtare" (www.journals.sas.ac.uk), <<https://journals.sas.ac.uk/deeslr/article/view/2130/2060?>>, qasur më 28 korrik 2022 [3]

⁹Vini re se rregulli 139 i Dhomave të Specializuara të Kosovës, në nënparagrafin 3, parasheh se "paneli nuk do të përcaktoj kusht ligjor që kërkon mbështetje të provës në mënyrë që të provohet ndonjë krim apo sjellje kriminale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara".

meta data, kjo është gjurma digjitale e burimit që mund të shërbejë si dëshmi për vërtetësinë e burimit.¹⁰

3. Prokurori Special kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Në rastin e Gucatit dhe Haradinajt, të akuzuarit u akuzuan, jo me prova dokumentare të krimeve të luftës apo krimeve kundër njerëzimit siç shihet zakonisht në gjykatat penale ndërkombëtare, por u akuzuan për frikësim gjatë procedurës penale, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës penale. Sjellja e të akuzuarve u bë publike dhe u dokumentua ashtu siç ishte kryer.¹¹ Kjo bëri që shumica e provave të gjykimit të jenë në formë digjitale të videove të konferencave për shtyp, intervistave dhe postimeve në Facebook.

3.1 Konferencat për shtyp dhe intervistat

Në grupin e parë të provave, përkatësisht konferencat për shtyp dhe intervistat, prokuroria ka siguruar video-materialin me transkripta dhe përkthime. Prokuroria e ka ngritur rëndësinë e këtyre materialeve për ecurinë e rastit. Në të vërtetë, video-provat në këtë kategori janë jetike për rastin, pasi ato ofrojnë video dëshmi të sjelljes kriminale të të akuzuarit, pasi që gjatë atyre konferencave për shtyp i akuzuari kishte zbuluar emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve. Në argumentimin e tyre për vërtetësinë e provave, prokuroria theksoi se duke qenë se provat janë me burim të hapur, ato janë në gjendje të jenë që ta vërtetojnë vetën.¹² Për më tepër, mbrojtja nuk e konteston se provat janë të vërteta, por përkundrazi se ato nuk provojnë ndonjë formë të sjelljes së paligjshme.¹³

Në këtë rast, përdorimi i videove të konferencave për shtyp dhe intervistave ka vlerë të lartë provuese pasi ofron prova të vërtetuara se sjellja kriminale e të akuzuarit ka ndodhur në të vërtetë. Për më tepër, përdorimi i një burimi të tillë ndihmon gjithashtu që çdo dëshmitar tjetër i mundshëm i asaj sjelljeje kriminale të mos jetë në rrezik nëse ai/ajo do të dëshmonte në gjykatë. Veç kësaj, kombinimi i provave vizuale me ato të shkruara (p.sh., transkriptet, përkthimet, etj.) ofron bazë të fortë mbi të cilën prokuroria mund të provojë sjelljen kriminale të të akuzuarit.

3.2 Postimet në Facebook

Postimet në Facebook që prokuroria i ka sjell në gjykatë ishin të natyrës së dyfishtë. Natyra e parë lidhej me qëllimin e të akuzuarve për të bërë publike veprimtarinë e tyre kriminale si mjet për të arritur te publiku në masën më të madhe të mundshme.¹⁴ Natyra e dytë e postimeve në Facebook ka të bëjë me dashjen kriminale të të akuzuarit, përkatësisht postimet që kishin për

¹⁰Aida Ashouri, Caleb Bowers dhe Cherrie Warden, "Pasqyrim i përdorimit të provave digjitale në Gjykatat Penale Ndërkombëtare" (www.journals.sas.ac.uk), <<https://journals.sas.ac.uk/deeslr/article/view/2130/2060?>>, qasur më 28 korrik 2022, [4]

¹¹Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, KSC-BC-2020-07, kërkesa e prokurorisë për pranimin e provave, me shtojcën konfidenciale 1, 31 gusht 2021, [4]

¹²Ibid. [11]

¹³Ibid. [12]

¹⁴Ibid. [23(i)]

qëllim zbulimin e informacionit konfidencial të dëshmitarëve si dhe për t'u përdorur si mjet frikësimi për dëshmitarët.¹⁵

Për pranueshmërinë e provave, prokuroria theksoi se postimet janë marrë nga burime të hapura dhe si të tilla mund ta vërtetojnë vetën. Për më tepër, ata ngritën çështjen se në këto postime kishte identifikim të qartë të dërguesit si dhe datë të dërgimit të postimit në secilin prej postimeve të përdorura. Përveç kësaj, postimet në Facebook mund të mbështeten me intervistën dhe konferencat për shtyp, kështu që mund të nxirret data në bazë të këtyre ngjarjeve. Në të vërtetë, kjo me kusht që postimet të jenë të sakta dhe të besueshme.

Megjithatë, mbrojtja ngriti çështjen se llogaritë e z. Haradinaj dhe z. Gucati në Facebook nuk ishin qasur vetëm nga ata, por se ata kishin një ekip të mediave sociale që mund të kishte qasje në llogaritë e tyre.¹⁶ Mirëpo kjo vlen për interpretimin e postimeve gjatë fazës së gjyqimit, dhe nuk siguron ndonjë bazë për refuzim të postimeve si të papranueshme.

4. Konkludim

Si konkludim, ndërsa provat e mediave sociale mund të shoqërohen me sfida, disa raste si ai i Gucatit dhe Haradinajt, tregojnë prova të cilat nuk janë vetëm thelbësore në zbardhjen e një rasti, por edhe shërbejnë si bazë që çështja të paraqitet para gjykatave penale. Në të vërtetë, rasti para DHSK-së jo vetëm që mbështetej shumë në prova me burim të hapur, por u prezantua dhe u ndoq penalisht përmes materialeve ndërvepruese si klipet në YouTube nga intervistat në të cilat të pandehurit u panë duke u përfshirë në sjellje kriminale, pamje nga ekranet e postimeve në Facebook që ishin të natyrës nënçmuese për dëshmitarët dhe të cilat kishin për qëllim frikësimin e dëshmitarëve, si dhe video të konferencave për shtyp në të cilat të pandehurit shiheshin duke shkelur fshehtësinë e procedurës.

Megjithatë, ndonëse provat me burim të hapur duhet të merren gjithmonë me pak rezerva, ato nganjëherë kanë vlerë të lartë provuese, por mund të shkaktojnë sfida në lidhje me besueshmërinë e provave në gjykim. Meta datat si dhe vultat kohore janë elementë të rëndësishëm që duhen trajtuar si në fazën e procedurës paraprake për pranueshmërinë e tyre, ashtu edhe në fazën e gjyqimit për të ndërtuar një të kuptuar të qartë dhe linear të besueshmërisë së provave për gjykimin.

Megjithatë, është e rëndësishme që gjykatat penale të mirëpresin provat me burim të hapur, pasi ato janë një zhvillim i natyrshëm i botës sonë që është gjithnjë në ndryshim dhe e ndërlikur. Mediat sociale dhe llojet e tjera të platformave online janë pjesë gjithëpërfshirëse e epokës sonë digjitale dhe si të tilla, në të ardhmen, do të paraqesin një nga format kryesore të provave. Prandaj, është e rëndësishme që gjykatat të ndërtojnë bazë ligjore që këto lloj provash të pranohen në gjykatë.

Rasti para DHSK-së i dha një mundësi gjykatës që të merret me sfidat e epokës sonë dhe të përdorë platformat sociale si mjet për t'i dhënë fund mosdëshkimit të krimeve për faktin e thjeshtë se provat me burim të hapur mund të mos jenë të besueshme ndonjëherë. Në të vërtetë,

¹⁵ Ibid. [23(ii)]

¹⁶ Ibid. [26]

gjyqtarët lejuan që provat të përdoren në gjykim, duke mos i konsideruar ato si të papranueshme, por u caktua një prag i lartë i standardit të të provuarit si për prokurorinë ashtu edhe për mbrojtjen. Prandaj, duhet punuar me mjete të kohës sonë dhe të sigurohemi që këto mjete të mos lihen anash dhe, si të tilla, të mos përdoren në të ardhmen vetëm si një mjet për të ekspozuar krimet dhe ato të mbesin pa u ndëshkuar.



Bibliografia

Burimet dytësore:

- Ashouri A, Bowers C and Warden C, 'An Overview of the Use of Digital Evidence in International Criminal Courts' (www.journals.sas.ac.uk), <<https://journals.sas.ac.uk/deeslr/article/view/2130/2060?>>, qasur më 28 korrik 2022
- Mehandru N, and Koenig A, 'Open Source Evidence And The International Criminal Court' (*Harvardhrj.com*, 2022) <<https://harvardhrj.com/2019/04/open-source-evidence-and-the-international-criminal-court/>> qasur më 28 korrik 2022
- Hiatt K, 'Open Source Evidence On Trial' (*Yalelawjournal.org*, 2022) <<https://www.yalelawjournal.org/forum/open-source-evidence-on-trial>> qasur më 31 korrik 2022

Rastet:

- Finlanda, Gjykata e Qarkut Pirkanmaa, Aktgjykimi, R 16/1304, 18 mars 2016
- Prokurori kundër Aria Ladjedvardi, Aktgjykimi, 5-3 StE 2/16 – 4 – 1/16, 12 korrik 2016
- Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, KSC-BC-2020-07, aktakuza, 4 tetor 2021

Përgatiti:

Emma Gonzales-Puell

Praktikante në Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë

Ish studente, L.L.M - E Drejta Publike Ndërkombëtare në *Universitetin e Amsterdemit*

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit “Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë” nga organizata “National Endowment for Democracy” përmes projektit të quajtur “Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës “National Endowment for Democracy”.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD